

VENDIM
Nr. 24, datë 21.3.2014

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “CEZ TRADE ALBANIA” SHPK PËR FILLIMIN E
PROCEDURAVE PËR HEQJEN E LICENCAVE: NR. 91 SERIA TE10P DHE NR. 92 SERIA FP10K,
DHËNË ME VENDIMET NR. 1 DHE NR. 2 DATË 20.1.2010 TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË
ERE-s PËR AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE TË FURNIZUESIT
TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”; 9; 18, pika 1 germa “e”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 34 dhe 35 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të nenit 5 të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencës”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.3.2014, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s, lidhur me heqjen e licencës shoqërisë “CEZ Trade Albania” sh.p.k., konstatoi se:

- Shoqëria “CEZ Trade Albania” sh.p.k., me vendimin nr. 1, datë 20.1.2010 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, është pajisur me licencën nr. 91, seria TE10P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike të vlefshme për një afat 5-vjeçar.
 - Shoqëria “CEZ Trade Albania” sh.p.k., me vendimin nr. 2 datë 20.1.2010 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, është pajisur me licencën nr. 92, seria FP10K, për aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, të vlefshme për një afat 5-vjeçar.
 - ERE, me vendimin nr. 13, datë 3.3.2014, miratoi kërkesën e OST sh.a. për zgjidhjen e “Marrëveshjes për pjesëmarrjen në treg”, të lidhur ndërmjet “CEZ Trade Albania” sh.p.k. në cilësinë e tregtuesit të energjisë elektrike dhe OST sh.a. –OT dhe kërkesën e OST sh.a. zgjidhjen e “Marrëveshjes për pjesëmarrjen në treg”, të lidhur ndërmjet “CEZ Trade Albania” sh.p.k. në cilësinë e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike dhe OST sh.a.–OT.
 - “CEZ Trade Albania” sh.p.k., me shkresën nr. 12/26 Prot., datë 26.12.2013 (depozituar në OST) njofton se kjo shoqëri i është nënshtruar procesit të likuidimit.
 - Shoqëria “CEZ Trade Albania” sh.p.k., me shkresën nr. 1058 Prot., datë 27.12.2013, ka kërkuar nga ERE fillimin e procedurave për heqjen e licencave të sipërcituara duke qenë se është shoqëri në likuidim dhe dëshiron të dalë nga tregu i energjisë elektrike me vullnetin e saj.
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “CEZ Trade Albania” sh.p.k., për heqjen e licencës me nr. 91 seria TE10P, miratuar me vendimin nr. 1, datë 20.1.2010 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të vlefshme për një afat 5-vjeçar.
 2. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “CEZ Trade Albania” sh.p.k., për heqjen e licencës me nr. 92 seria FP10K, miratuar me vendimin nr. 2, datë 20.1.2010 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, për aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, të vlefshme për një afat 5-vjeçar.
 3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë “CEZ Trade Albania” sh.p.k., për vendimarrjen e ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti